



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 680/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rustem Thaqi kryesues, Faton Ademi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Lista e Pavarur – Bekim Jashari, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës, për shkak të keqpërdorimit të fletëvotimeve, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të datës 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur më datë 20.10.2021, mori këtë:

### V E N D I M

**Refuzohet** e pabazuar ankesa Anr.680/2021 e datës 18.10.2021, e paraqitur nga Lista e Pavarur – Bekim Jashari, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës, për shkak të keqpërdorimit në vendvotimin QV1122B/01D dhe përsëritjen e votimit në këtë vendvotim.

### A r s y e t i m

Me datë 18.10.2021, PZAP, ka pranuar ankesë nga Lista e Pavarur – Bekim Jashari,, me të cilën pretendon se: në vendvotimin nr.1122B/01D, gjatë numërimit të votave nga anëtarët e KVV-së, është verifikuar që 3 fletëvotime kanë qenë të pa vulosura në kutinë e votimit, që lenë shumë dyshime për vjedhje të votave përmes “trenit bullgar”. Gjithashtu kërkon nga PZAP, që të përsëritet votimi në këtë vendvotim.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, me të cilën ka theksuar se: është e pa mundur të ndodhë “treni bullgar”, për shkak të identifikimit të fletëvotimit me vendvotim sepse fletëvotimet kane numrin serik unik dhe numrin e vendvotimit të personalizuar dhe nga ana tjetër këshilli i vendvotimit është përbërë nga 5 anëtarë, dhe kryesuesi, në rastin kontestues ka qenë i Lëvizjes Vetëvendosje, ndërsa gjatë ditës nuk ka pasur asnjë parregullsi të shfaqur nga asnjë vëzhgues në librat e vendvotimit përkatës. Gjithashtu thekson se në lidhje me pretendimet e ankuesit PDK, ka pranuar një deklaratë të Adnan Asllanaj, i cili thekson se në qendrën përkatëse të votimit procesi i votimit ka shkuar jashtëzakonisht mirë, nuk ka pasur asnjë fletëvotim të pa vulosur dhe dhënësi i tyre nuk ka qenë i PDK.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

### Ankesa është e pabazuar

Paneli, vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me pretendimet e tij në ankesë. Paneli konform nenit 8

par. 5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr. 02/2015, ndërmori hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës, duke verifikuar vendvotimin nr.1122B/01D, në QNR, dhe gjeti se të njëjtat pretendime janë të pa bazuara. Nga rezultatet e hetimit të bërë nga ana e PZAP, lidhur me vendvotimin e cekur në ankesë, rezultoi fakti se i njëjti vendvotim nuk gjendet në Komunën e Skenderajt, por gjendet në Komunën e Mitrovicës Jugore. Andaj nga një konstatim i tillë, duke u mbështetur në hetimin e PZAP-së dhe në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, ku barra e të provuarit bie mbi ankuesin, e që në rastin konkret, ankuesi nuk ka paraqitur vendvotimin e saktë, sipas përshkrimit të ankesës paneli, refuzoi ankesën si të pa bazuar.

Andaj, Paneli vlerësoi se ankesa e Lista e Pavarur – Bekim Jashari, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës ka mospërputhje në mesë të pretendimeve në ankesë dhe vendvotimit nr.1122B/01D.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**

Anr.680/2021 më datën 20.10.2021



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa, sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi